REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike

Datë 5.10.2026

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin *(titulli i projektvendimit)*: **PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 33.211.047 (TRIDHJETË E TRE MILIONË E DYQIND E NJËMBËDHJETË MIJË E DYZET E SHTATË) LEKË NGA BUXHETI I BASHKISË DURRËS PËR BASHKËFINANCIMIN NË MASËN 50% ME MINISTRINË E EKONOMISË DHE INOVACIONIT PËR SUBVENCIONIMIN E QIRASË PËR VITIN 2026, PËR FAMILJET QË PËRMBUSHIN KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BONUSIT TË STREHIMIT**

Baza ligjore:

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social", i ndryshuar, VKM-së nr. 1093, datë 28.12.2015 "Për miratimin e proçedurave, kritereve dhe përparësive për dhënien e bonusit të strehimit", VKM-së nr.574, datë 29.08.2012 "Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për t'u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore", VKM-së nr. 814, datë 03.12.2004 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit", VKM-së nr. 362, datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së suvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në suvencionimin e qirasë në tregun e lirë , nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij" , Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 459, datë 03.07.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Ministrisë përgjegjës për strehim", Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019, "Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përftitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.73 datë 23.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.44 datë 09.07.2026 "Për për miratimin e ndryshimit të VKB-së nr. 7, datë 10.02.2026 "Për miratimin e listës emërore të familjeve që përmbushin kriteret ligjore për përfitimin e bonusit të strehimit që do të akordohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit në favor të Bashkisë Durrës për subvencionimin e qirasë për vitin 2026", sipas përgjigjes së

ardhur nëpërmjet postës elektronike më datë 02.10.2026 nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, e cila konfirmon se financimi nga Buxheti i Shtetit, sipas kategorisë së të ardhurave për frymë në të cilën përfshihet Bashkia Durrës, mbulon 50% të vlerës së programit, e për rrjedhojë, Bashkia Durrës duhet të sigurojë bashkëfinancimin në masën deri në 50% të vlerës së programit.

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër *(Çfarë propozohet në projektvendim):*

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë konform akteve ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 33.211.047 (tridhjetë e tre milionë e dyqind e njëmbëdhjetë mijë e dyzet e shtatë lekë) Lekë me qëllim subvencionimin e bonusit të qirasë në masën 50% në bashkëfinancim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit për familjet në vështirësi ekonomike që përfitojnë bonus për strehim për vitin 2026.

2. Fondi prej 33.211.047 (tridhjetë e tre milionë e dyqind e njëmbëdhjetë mijë e dyzet e shtatë lekë) Lekë që do të përdoret për subvencionimin e bonusit të qirasë të merret nga fondi rezervë i planifikuar në buxhetin e vitit 2026, sipas VKB-në nr.73, datë 23.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028".

3. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):

Buxheti i bashkisë 2027.

Drejtoria/Sektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtoria e Shërbimeve Sociale.

Impakti social/grupet që preken:

Banorët e Bashkisë Durrës.

A është objekt konsultimi: *(PO/JO)*

JO.

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i **Strehimit dhe Shërbimeve Publike**, u mblodhë më datë 5.10.2026, dhe shqyrtoi pikën nr. 4 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Kryetarja Hapo ndërhyrje. Përgjëruese bollëse. Duam shpjegime relacioni. Ish Minatin ka kërkuar që duke pasë se të evidentuar për fëmijë janë të lartë në Durrës, të bëhet verifikimi

të jetë jo më pas se 10 ditë nga Bashkimi. Në çdo kërkesë formulimi e vet dhënë të merret kujdesin. Kërkesës do vendosen për me pushtet fadro për mbështetjen e bursit të strehimit. Pjesë jonë shkruar në këtë propozimin të miratohet ole. të lëshohet pjesë dytësore miratimin në mbledhjen e këshillit.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
b- Miratimin e projekt aktit
c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
e- _____

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike

1	Kryetar	Marsida Feshti
2	Zv/Kryetar	Sami Osmani
3	Sekretar	Joniada Musaraj
4	Anëtar	Dorian Isaj
5	Anëtar	Elisabeta Mataj
6	Anëtar	Flutura Kasa
7	Anëtar	Edlira Shemsi
8	Anëtar	Kontjana Kuçi
9	Anëtar	Erald Dalipi

Përfaqësuesi Bashkisë Diana Kamberaj Jahjaj